



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT
DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROKURIMEVE

Nr. ____ Prot

Tiranë: ____ / ____ /2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje stola dhe kosha”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):

Stola ne parqe – 39113600-3; Kosha mbeturinash – 39224340-3

Vlera e Fondit Limit është: 12,481,665.40 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e e gjashtëdhjetë e pesë presje dyzet) **lekë pa TVSH**

“Procedurë e hapur”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së

Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, autorizim distributori, marrëveshje bashkëpunimi, kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent, që provon të drejtën e operatorit ekonomik për të ofruar dhe furnizuar produktet objekt prokurimi.

Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues, duhet të deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës që provon prodhimin e artikujve objekt prokurimi ose të artikujve të ngjashëm.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

Ky kriter vendoset për të garantuar që operatori ekonomik ka akses real dhe të ligjshëm në produktet që ofron, si dhe ka mundësi të realizojë furnizimin brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekt i prokurimit janë artikuj që mund të prodhohen nga vetë operatori ekonomik ose të sigurohen nëpërmjet prodhuesve, distributorëve apo furnitorëve të autorizuar, autoriteti kontraktor duhet të ketë siguri mbi burimin e furnizimit dhe aftësinë e operatorit për të dorëzuar produktet sipas specifikimeve teknike.

Kriteri është në përpjesëtim dhe i lidhur me objektin e kontratës, pasi artikujt objekt prokurimi, konkretisht stolat dekorativë, koshat plastikë 120 L dhe koshat dekorativë metalikë me strukturë rrethuese druri, duhet të furnizohen në sasinë, cilësinë dhe afatin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa nuk kufizohet vetëm në autorizim prodhuesi, por pranon edhe autorizim distributori, marrëveshje bashkëpunimi, kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent. Në këtë mënyrë garantohej konkurrencë e hapur dhe nuk përjashtohen operatorët ekonomikë që nuk janë vetë prodhues, por kanë marrëdhënie të rregullta furnizimi me prodhues, distributorë apo furnitorë të këtyre artikujve.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik është vetë prodhues, ai nuk ngarkohet me detyrimin për të paraqitur autorizim nga të tretë, por duhet të deklarojë dhe provojë këtë status. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor garantohej se operatori ekonomik kontraktues ka mundësi reale të sigurojë produktet e ofruara dhe të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog teknik / broshurë të lëshuar nga prodhuesi/t, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat që oferton, si dhe specifikimet përkatëse të tyre, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Katalogu/broshura teknike duhet të përmbajë elementë të qartë dhe autentikë të prodhuesit/markës, si: logo, website, e-mail, numër telefoni, adresë, ose të dhëna të tjera identifikuese, me qëllim verifikimin e burimit të dokumentit dhe lidhjen e tij me produktin e ofertuar.

Në rast se paraqiten fragmente katalogu/broshurë, ato duhet të tregojnë qartë se janë pjesë e katalogut/broshurës përkatëse, si dhe cilit produkt, modeli, markë ose prodhuesi i përkasin.

Mosparaqitja e katalogut/broshurës teknike, ose paraqitja e dokumentacionit nga i cili nuk identifikohet qartë produkti i ofertuar dhe prodhuesi/marka përkatëse, do të përbëjë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme vendoset në mbështetje të nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë dëshmi që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë fotografitë apo katalogët teknikë.*

Paraqitja e katalogut/broshurës teknike është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve të ofruara me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Objekti i prokurimit përfshin artikuj fizikë me karakteristika të matshme teknike dhe funksionale, konkretisht stol dekorativ me krahë gize, kosh plastik për mbetje urbane 120 L dhe kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri.

Nëpërmjet katalogut/broshurës teknike, komisioni i vlerësimit ka mundësi të verifikojë elementë të rëndësishëm të produktit, si përmasat, materialet, volumin/kapacitetin, elementët konstruktivë, trajtimin sipërfaqësor, funksionalitetin dhe karakteristikat kryesore teknike të artikujve të ofertuar.

Kërkesa për markimin e qartë të produktit dhe specifikimeve përkatëse është e nevojshme për të shmangur paqartësitë gjatë vlerësimit, pasi katalogët/broshurat mund të përmbajnë disa modele, variante apo përmasa produktesh. Markimi i qartë mundëson verifikim objektiv, transparent dhe të barabartë të ofertave.

Ky kriter është në përpjesëtim me objektin e kontratës dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garanton që produktet e ofruara të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme në raport me specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofruara me standardet, normat ose referencat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi. Në përmbushje të kësaj pike, operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikata konformiteti, deklarata konformiteti, deklarata performance, raporte testimi ose dokumentacion tjetër ekuivalent**, të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione/organe të pavarura të akredituara, sipas rastit, nga ku të vërtetohet përputhshmëria e produkteve të ofruara me standardet, normat ose referencat teknike të kërkuara në shtojcën e specifikimeve teknike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, nenin 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1, si dhe në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

Autoriteti kontraktor gjykon se ky kriter është i nevojshëm dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi artikujt objekt prokurimi do të përdoren në ambiente publike të jashtme, si rrugë, lulishte, parqe, sheshe dhe hapësira të tjera urbane, ku kërkohet siguri, qëndrueshmëri, funksionalitet dhe cilësi e provuar e produkteve.

Duke qenë se produktet do të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe do të ekspozohen ndaj përdorimit të përditshëm, kushteve atmosferike dhe konsumimit fizik, autoriteti kontraktor duhet të garantojë se mallrat e ofruara përmbushin standardet/normat teknike të kërkuara në specifikimet teknike.

Kriteri është proporcional dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranon certifikata konformiteti, deklarata konformiteti, deklarata performance, raporte testimi ose dokumentacion tjetër ekuivalent, të lëshuar nga prodhuesi ose nga institucione/organe të pavarura të akredituara, sipas rastit. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor siguron që operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë produkte të përshtatshme, të sigurta dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantojë dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë një produkt i cili mund të përdoret pa rrezik kontaminues apo me efikasitet të ulët dhe shpërdorim energjetik.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e certifikatave që vertetojnë se mallrat e mesiperm duhet të jenë konform standardeve në fuqi kombëtare, europiane dhe botërore dhe kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për zërat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kërkesë Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanisë prodhuese, adresa, website	Emertimi i katalogut	Kodi i produktit ose nr. faqes në katalog.
----	-----------------------	---	----------------------	--

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Operatori ekonomik duhet të plotësojë emrin, adresën dhe website-in e kompanisë prodhuese, emërtimin e katalogut/broshurës/skedës teknike të prodhuesit, si dhe referencën në katalog, kodin e produktit ose numrin e faqes ku gjenden specifikimet teknike të produktit të ofertuar.

Në rast se produkti nuk ka kod të veçantë në katalog, operatori ekonomik duhet të plotësojë numrin e faqes ose referencën përkatëse në dokumentacionin teknik, ku Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë specifikimet e plota teknike të produktit të ofertuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme vendoset në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, lidhur me të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar dokumentacion që provon përputhshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike.*

Qëllimi i këtij kriteri është orientimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Duke qenë se objekt i prokurimit janë disa artikuj me karakteristika teknike të veçanta, konkretisht stol dekorativ me krahë gize, kosh plastik për mbetje urbane 120 L dhe kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri, është e nevojshme që produktet e ofertuar të identifikohen qartë.

Plotësimi i dokumentit “Ofertë Teknike” mundëson lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet artikullit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, produktit të ofertuar nga operatori ekonomik dhe dokumentacionit teknik/katalogut ku verifikohen specifikimet përkatëse.

Ky kriter është proporcional dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, pasi nuk kërkon dokumentacion shtesë të panevojshëm, por vetëm sistemin e informacionit teknik të produkteve të ofertuar, me qëllim vlerësimin e qartë, transparent dhe të barabartë të ofertave.

2.3.6 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga 1 (një) copë mostër për secilin nga artikujt objekt prokurimi, konkretisht:

1. Stol dekorativ me krahë gize;
2. Kosh plastik për mbetje urbane 120 L;
3. Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me produktet e deklaruara në ofertën teknike, katalogë/broshura/skeda teknike, si dhe me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Mostrat do të paraqiten në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor dhe do të administrohen me procesverbal, në përputhje me Udhëzimin e APP-së nr. 03, datë 12.04.2022, “Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Mosparaqitja e mostrave, paraqitja e mostrave që nuk përputhen me produktet e deklaruara në dokumentacionin teknik, ose mospërputhja e tyre me specifikimet teknike të kërkuara, përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, sipas të cilit autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë paraqitjen e mostrave për të provuar përputhshmërinë e mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Udhëzimi i APP-së nr. 03, datë 12.04.2022, për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.**

Kërkesa për paraqitjen e mostrave është e nevojshme për shkak të natyrës së artikujve objekt prokurimi. Stolat dhe koshat janë produkte fizike që do të përdoren në ambiente publike të jashtme, si rrugë, lulishte, parqe, sheshe dhe hapësira të tjera urbane, ku kërkohet siguri, qëndrueshmëri, funksionalitet dhe përshtatshmëri për përdorim të përditshëm nga qytetarët.

Për këta artikuj, disa elementë të rëndësishëm nuk mund të verifikohen plotësisht vetëm nëpërmjet katalogëve, skedave teknike apo deklaratave të prodhuesit. Nëpërmjet mostrës, Autoriteti Kontraktor ka mundësi të verifikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë materialin, cilësinë e punimit, përmasat, qëndrueshmërinë, funksionalitetin, trajtimin sipërfaqësor të drurit dhe metalit, elementët fiksues, sistemet e hapjes/mbylljes, rezistencën e përgjithshme të produktit, si dhe pamjen dekorative dhe përshtatshmërinë me funksionin urban të artikujve.

Për stolin dekorativ me krahë gize, mostra është e nevojshme për të verifikuar cilësinë e krahëve/këmbëve metalike, ristelave të drurit, mënyrën e fiksimit, qëndrueshmërinë, përmasat, trajtimin mbrojtës dhe përshtatshmërinë për vendosje në hapësira publike.

Për koshin plastik për mbetje urbane 120 L, mostra është e nevojshme për të verifikuar volumin, materialin plastik, qëndrueshmërinë, peshën, rrotat, kapakun, funksionalitetin në përdorim dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike të përcaktuara për këtë artikull.

Për koshin dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri, mostra është e nevojshme për të verifikuar strukturën metalike, ristelat e drurit, koshin e brendshëm, derën, sistemin e mbylljes, trajtimin sipërfaqësor, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin gjatë përdorimit në ambiente publike.

Kriteri është proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi kërkohet vetëm nga 1 (një) mostër për secilin artikull, ndërsa vlerësimi i tyre do të bëhet vetëm në raport me specifikimet teknike të shpallura dhe jo mbi elementë subjektivë apo të paparashikuar në dokumentet e tenderit.

Mostrat do të shërbejnë për të verifikuar nëse artikulli fizik i paraqitur nga operatori ekonomik përputhet me produktin e deklaruar në dokumentacionin teknik, si dhe me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit.

Mosparaqitja e mostrave në ditën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, paraqitja e mostrave që nuk përputhen me produktet e deklaruara në dokumentacionin teknik, ose mospërputhja e mostrave me specifikimet teknike të kërkuara, do të përbëjë shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor siguron që produktet e ofruara nuk përputhen vetëm formalisht me dokumentacionin e paraqitur, por edhe fizikisht me kërkesat teknike, funksionale dhe cilësore të procedurës, duke garantuar realizimin me sukses të kontratës dhe furnizimin e artikujve të përshtatshëm për përdorim publik..

Mostrat do të administrohen me procesverbal dhe do të vlerësohen vetëm në raport me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për paraqitjen e mostrave vendoset me qëllim verifikimin fizik të përputhshmërisë së artikujve me produktet e deklaruara në katalogë/skeda teknike dhe me specifikimet teknike të kërkuara.”

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues, si dhe vendosjen e gomave pranë ambienteve të tij, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore perfituese.

Në përputhje me këto dispozita, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë **dokumentacion plotësues** që dëshmon se operatori ekonomik është në gjendje të realizojë kontratën, duke përfshirë **aspekte logjistike dhe operacionale**, siç është **transporti dhe dorëzimi i mallrave në vendin e përcaktuar**. Ky kriter është **proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës**, dhe siguron që **furnizimi të realizohet në përputhje me kushtet teknike dhe vendndodhjet e specifikuara nga autoriteti kontraktor**.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Stol dekorativ me krahë gize

Përmasat pranohen me tolerancë $\pm 3\%$, përveç rasteve kur kërkesa është përcaktuar si vlerë minimale ose kur parashikohet ndryshe.



(Fotoja/skica është për qëllim ilustrimi dhe shërben vetëm për identifikimin orientues të formës dhe përmasave kryesore të stolit. Pranohen modele, forma, zgjidhje konstruktive, materiale, elementë fiksues, trajtime sipërfaqësore dhe sisteme lysterjeje ekuivalente, me kusht që të përmbushin kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në këto specifikime.)

- Stoli të jetë dekorativ dhe i përshtatshëm për vendosje në lulishtet e qytetit, parqe, sheshe, trotuare dhe ambiente të tjera publike të jashtme.
- Materialet e përdorura për ndërtimin e stolit duhet të jenë rezistente ndaj agjentëve atmosferikë, lagështisë, rrezatimit diellor dhe përdorimit të përditshëm në ambiente publike.
- Stoli duhet të përbëhet nga pjesa e ndenjës dhe pjesa mbështetëse, të cilat duhet të jenë të fiksuara në dy këmbët/krahët anësorë prej gize, ose materiali tjetër metalik ekuivalent.
- Materiali kryesor i përdorur duhet të jetë gizë dhe dru, ose materiale të tjera ekuivalente që garantojnë qëndrueshmëri, funksionalitet dhe rezistencë për përdorim në ambiente të jashtme.
- Përmasat orientuese të stolit, referuar skicës, duhet të jenë: gjatësia totale rreth 1320 mm $\pm 3\%$; thellësia/gjerësia totale rreth 670 mm $\pm 3\%$; lartësia totale rreth 770 mm $\pm 3\%$; lartësia e ulës rreth 450 mm $\pm 3\%$.
- Ristelatat e drurit duhet të jenë të ndërtuara prej dru lisi të përpunuar, ose dru tjetër ekuivalent me rezistencë të përshtatshme për ambiente të jashtme, dhe të trajtuara me astar/bojë/llak mbrojtës, për të siguruar mbrojtje ndaj agjentëve atmosferikë.
- Ristelatat do të lyhen me bojë me ngjyrë, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
- Sasia e ristelave për çdo stol duhet të jetë 8 copë, ose zgjidhje tjetër ekuivalente konstruktive që garanton të njëjtin funksion, qëndrueshmëri dhe komoditet përdorimi.
- Përmasat orientuese të çdo ristele duhet të jenë: gjatësia 150 cm $\pm 3\%$; gjerësia 6 cm $\pm 3\%$; trashësia 3 cm $\pm 3\%$.
- Stoli duhet të jetë i përbërë nga dy këmbë/krahë prej gize, ose materiali metalik ekuivalent, të lyera me bojë të errët, me bojë elektrostatische, bojë me pjekje në furrë, trajtim antikoroziv ose sistem tjetër ekuivalent, për të siguruar mbrojtje ndaj agjentëve atmosferikë.
- Vidat për fiksimin e ristelave duhet të jenë prej materiali inoksi, ose materiali tjetër ekuivalent rezistent ndaj korrozionit, me kokë harkore/kokë çadër dhe me dado M8x50, në sasinë orientuese 16 copë për çdo stol, ose elementë të tjerë fiksues ekuivalentë që garantojnë qëndrueshmëri dhe siguri.
- Vidat e drurit për fiksimin e ristelave të drurit te pjastra duhet të jenë M4x20, në sasinë orientuese 8 copë për çdo stol, ose elementë të tjerë fiksues ekuivalentë.
- Elementi metalik/pjastra e çelikut duhet të jetë e lyer me bojë rezistente ndaj kushteve atmosferike, bojë me pjekje në furrë, bojë elektrostatische ose sistem tjetër ekuivalent mbrojtës.
- Stoli duhet të fiksohet me 4 upa dhe vida në dyshe, ose sistem tjetër ekuivalent ankorimi. Përmasat orientuese janë vida 8x80 dhe upa 10, ose elementë të tjerë ekuivalentë që garantojnë qëndrueshmëri në përdorim publik.

Boja e drurit për lyerjen e ristelave

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë akrilike, ose ekuivalent për përdorim në ambiente të jashtme.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth 1,20 $\pm$ 0,02 gr/ml.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 62%, ose ekuivalent.

- Shkalla e hollimit: 10–20%, në bazë ujore ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth 115 ± 5 KU, ose vlerë tjetër ekuivalente sipas skedës teknike të prodhuesit.
- Shkëlqimi: rreth $90\% \pm 5\%$ në kënd 60° , ose ekuivalent.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–3 orë në kushte laboratorike $23^\circ\text{C} / 50\% \text{ RH}$.
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 10 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent.
- VOC/TVOC – emetimi në ambient: duhet të jetë brenda kufijve të lejuar sipas ISO 16000 ose ekuivalent.
- Boja preferohet të jetë e pajisur me certifikim ECOLabel ose ekuivalent. Në mungesë të këtij certifikimi, pranohen skeda teknike, deklarata prodhuesi, certifikime të tjera mjedisore ose dokumentacion ekuivalent që provon përputhshmërinë mjedisore të produktit.
- Ngjyra e bojës do të caktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës ose përpara furnizimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Astari i bojës së drurit

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë alkide, ose ekuivalent për trajtimin e drurit.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,45 \pm 0,02$ gr/ml.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 55%.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth 115 ± 5 KU.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–4 orë, në kushte standarde laboratorike $23^\circ\text{C} / 50\% \text{ RH}$, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit për produkt ekuivalent.
- Koha për rilyerje: jo më shumë se 6–8 orë, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 100 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent.
- TVOC – emetimi në ambient: duhet të jetë brenda kufijve të lejuar sipas ISO 16000 ose ekuivalent.

Llaku i bojës së drurit

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë akrilike, ose ekuivalent.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,20 \pm 0,02$ gr/ml.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 35%.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth 45 ± 5 KU.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–3 orë, në kushte standarde $23^\circ\text{C} / 50\% \text{ RH}$, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit për produkt ekuivalent.
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 10 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.

- VOC/TVOC – emetimi në ambient: $\leq 0.2 \text{ mg/m}^3$, sipas ISO 16000 ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.

Boja e metalit për trajtimin e këmbëve/krahëve prej gize

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë akrilike, ose ekuivalent për metal/gizë.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,20 \pm 0,01 \text{ kg/l}$.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 72%, ose nivel tjetër ekuivalent që garanton mbrojtje të përshtatshme të metalit.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Shkalla e hapjes: $\geq 10 \text{ m}^2/\text{litër}$, në sipërfaqe të lëmuara, ose vlerë tjetër ekuivalente sipas skedës teknike të prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth $95 \pm 5 \text{ KU}$, ose vlerë tjetër ekuivalente sipas skedës teknike të prodhuesit.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 4 orë, në kushte standarde $23^\circ\text{C} / 50\% \text{ RH}$, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit për produkt ekuivalent.
- Aftësia mbuluese: $\geq 99,5\%$ – Klasa I, sipas EN ISO 6504-3 ose ekuivalent, ose klasë/vlerë tjetër ekuivalente që garanton mbulim të përshtatshëm.
- Klasa e rezistencës ndaj larjes: Klasa I, sipas ISO 11998 ose ekuivalent, ose klasë tjetër ekuivalente.
- VOC në produktin e gatshëm: $\leq 100 \text{ g/l}$, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.
- TVOC – emetimi në ambient: $\leq 20 \text{ mg/m}^3$, sipas ISO 16000-9 ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.
- Ngjyra e bojës do të caktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës ose përpara furnizimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Primer/astar antiruxho për trajtimin e këmbëve/krahëve prej gize


- Lloji i rrëshirës: rrëshirë alkide, ose sistem tjetër ekuivalent antikorroziv.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,45 \pm 0,02 \text{ gr/ml}$, ose sipas vlerës së deklaruar nga prodhuesi për produkt ekuivalent.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 75%, ose nivel tjetër ekuivalent që garanton mbrojtje antikorrozive.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth $115 \pm 5 \text{ KU}$, ose vlerë tjetër ekuivalente sipas skedës teknike të prodhuesit.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–4 orë, në kushte standarde $23^\circ\text{C} / 50\% \text{ RH}$, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit për produkt ekuivalent.
- Koha për rilyerje: jo më shumë se 6–8 orë, ose sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- VOC në produktin e gatshëm: $\leq 100 \text{ g/l}$, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.

- TVOC – emetimi në ambient: $\leq 20 \text{ mg/m}^3$, sipas ISO 16000-9 ose ekuivalent, ose brenda kufijve të lejuar për këtë kategori produkti.

2. Kosh plastik për mbetje urbane 120 L

Përmasat, pesha dhe karakteristikat teknike pranohen me tolerancë sipas parashikimeve më poshtë, përveç rasteve kur kërkesa është përcaktuar si vlerë minimale ose maksimale.

Skica/fotoja është për qëllim ilustrimi dhe shërben vetëm për identifikimin orientues të dimensioneve A, B, C, D, E, F dhe G. Pranohen modele, forma, zgjidhje konstruktive, materiale, dimensione dhe elementë teknikë ekuivalentë, me kusht që produkti të jetë me volum 120 L dhe të jetë në përputhje me standardin EN 840-1:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020, ose ekuivalent.



Skicë orientuese e koshit plastik 120 L

- Volumi: 120 L, me tolerancë $\pm 5\%$.
- Pesha totale: rreth 8 deri në 8.5 kg,
- Peshëmbajtja: jo më pak se 48 kg.
- Masa totale e lejueshme: jo më pak se 60 kg.

- Certifikimi/konformiteti i produktit: Koshi duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardin EN 840-1:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020, ose ekuivalent.
- Materiali i ndërtimit të kontenierit/koshit: trupi i koshit duhet të jetë i prodhuar prej materiali HDPE – High Density Polyethylene, ose materiali tjetër plastik ekuivalent, i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe për mbetje urbane.
- Materiali duhet të jetë rezistent ndaj kimikateve, rezistent ndaj goditjeve dhe përdorimit të përditshëm, i mbrojtur ndaj rrezeve UV, i përshtatshëm për përdorim në kushte atmosferike të jashtme, rezistent ndaj temperaturave nga rreth -30°C deri në +80°C ose diapazon tjetër ekuivalent i deklaruar nga prodhuesi, si dhe 100% i riciklueshëm ose i prodhuar nga material i riciklueshëm/ekuivalent sipas deklarimit të prodhuesit.
- Ngjyra standarde: preferohet ngjyra jeshile. Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë ngjyrën përfundimtare në momentin e nënshkrimit të kontratës ose përpara furnizimit. Pranohen edhe ngjyra të tjera sipas kërkesës së AK-së.
- Diametri i gomave: rreth 200 mm $\pm 5\%$.
- Aksi: gjatësia e aksit rreth 460 mm $\pm 5\%$, prej çeliku të galvanizuar, çeliku të trajtuar kundër ndryshkut ose materiali tjetër ekuivalent rezistent ndaj korrozionit.
- Produkti i ofruar duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardin EN 840-1:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020, ose ekuivalent.
- Prodhuesi i produktit të ofruar duhet të jetë i pajisur me certifikime të sistemeve të menaxhimit ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, ose ekuivalente, të vlefshme në fushën e prodhimit të koshave/kontenierëve plastikë, produkteve plastike ose pajisjeve për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Dimensionet e koshit plastik

Dimensionet e koshit pranohen me tolerancë $\pm 2\%$, ose sipas tolerancave të lejuara nga standardi përkatës i prodhimit, me kusht që të mos cenohet volumi, funksionaliteti dhe përputhshmëria me standardin teknik të kërkuar.

Dimensioni	Vlera orientuese
A	475–480 mm $\pm 2\%$
B	550–560 mm $\pm 2\%$
C	940–960 mm $\pm 2\%$
D	870–900 mm $\pm 2\%$
E	480–490 mm $\pm 2\%$
F	460–470 mm $\pm 2\%$
G	370–380 mm $\pm 2\%$

Dimensionet e koshit pranohen me tolerancë $\pm 2\%$. Pranohen vetëm ato devijime që janë të lejuara nga standardi EN 840-1:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020, ose ekuivalent, dhe që nuk cenojnë volumin 120 L, peshëmbajtjen, masën totale të lejueshme, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e produktit.

3. Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri

Përmasat pranohen me tolerancë $\pm 3\%$, përveç rasteve kur kërkesa është përcaktuar si vlerë minimale ose kur parashikohet ndryshe.



(Fotoja/skica është për qëllim ilustrimi. Pranohen modele, forma, zgjidhje konstruktive, materiale, elementë fiksues, trajtime sipërfaqësore dhe sisteme lysterjeje ekuivalente, me kusht që të përmbushin kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në këto specifikime.)

- Koshi dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri do të shërbejë për grumbullimin e mbetjeve urbane në ambiente publike të jashtme, si lulishte, parqe, sheshe, trotuare dhe hapësira të tjera urbane.
- Koshi duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe materialet e përdorura duhet të jenë rezistente ndaj agjentëve atmosferikë, lagështisë, rrezatimit diellor dhe përdorimit të përditshëm në ambiente publike.
- Koshi përbëhet nga pjesa e kafazit/dekorit të jashtëm, brenda të cilit do të instalohet koshi metalik për grumbullimin e mbetjeve.
- Kafazi i koshit duhet të përbëhet nga strukturë bazë metalike, e mbuluar me ristela druri.

- Mënyra e vendosjes dhe heqjes së koshit të brendshëm duhet të kryhet nga pjesa e përparme, e cila duhet të jetë e pajisur me derë metalike me çelës, ose sistem tjetër ekuivalent sigurimi/mbylljeje që mundëson mirëmbajtjen dhe zbrazjen e koshit.
- Dera metalike duhet të jetë e fiksuar me dy mentesha të fshehura/të padukshme nga jashtë, ose me sistem tjetër ekuivalent menteshash që garanton funksionim, siguri dhe estetikë.
- Hedhja e mbeturinave në kosh duhet të bëhet nëpërmjet hapësirës ndërmjet kafazit të jashtëm dhe kovës/koshit të brendshëm. Hapësira funksionale e hedhjes së mbetjeve të jetë me përmasa orientuese 31 x 60 cm $\pm 3\%$.
- Kova/koshi i brendshëm nga sipër duhet të jetë i hapur dhe i mbuluar/mbrojtur nga sipër me llamarinë në formë katrore, që pengon futjen e drejtpërdrejtë të ujërave të shiut dhe ruan funksionalitetin e përdorimit.
- Përmasat orientuese të kafazit të jashtëm duhet të jenë 113 x 60 cm $\pm 3\%$.
- Kafazi i jashtëm duhet të jetë i përbërë nga 3 ristela druri në secilën nga dy anët, me përmasa orientuese 113 x 10 x 5 cm $\pm 3\%$, si dhe 3 ristela druri sipër, me përmasa orientuese 60 x 10 x 5 cm $\pm 3\%$.
- Ristelat e drurit duhet të jenë të fiksuara me vida druri tip “kokë kryq”, prej inoksi, çeliku të galvanizuar ose materiali tjetër ekuivalent rezistent ndaj korrozionit, me përmasa orientuese 6 x 60 mm, ose elementë të tjerë fiksues ekuivalentë që garantojnë qëndrueshmëri dhe siguri.
- Kafazi ku vendoset koshi duhet të ketë strukturë metalike me përmasa orientuese 80 x 48 cm $\pm 3\%$, që të garantojë vendosjen, heqjen dhe përdorimin normal të koshit të brendshëm.
- Koshi i brendshëm metalik, prej materiali hekuri/çeliku të zinguar, çeliku të galvanizuar ose materiali tjetër ekuivalent, duhet të ketë përmasa orientuese 60 x 30 cm $\pm 3\%$, që të garantojë kapacitet dhe funksionalitet të përshtatshëm për mbetjet urbane.
- Struktura metalike duhet të ndërtohet prej llamarine të zinguar, çeliku të galvanizuar ose materiali tjetër ekuivalent rezistent ndaj korrozionit, me trashësi/spesor jo më pak se 2 mm, ndërsa llamarina e zinguar që do të përdoret për koshin e brendshëm duhet të jetë me trashësi/spesor jo më pak se 1–1.2 mm, ose material tjetër ekuivalent që garanton qëndrueshmëri mekanike dhe rezistencë ndaj përdorimit të përditshëm.

Llaku i bojës së drurit për trajtimin e ristelave

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë akrilike, ose rrëshirë tjetër ekuivalente për përdorim në ambiente të jashtme.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth 1,20 $\pm$ 0,02 gr/ml.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 35%.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth 45 $\pm$ 5 KU.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–3 orë, në kushte standarde 23°C / 50% RH.
- VOC në produktin e gatshëm: $\leq$ 10 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent.
- VOC/TVOC – emetimi në ambient: $\leq$ 0.2 mg/m³, sipas ISO 16000 ose ekuivalent.

Boja e metalit për lyerjen e strukturës metalike

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë akrilike, ose ekuivalent për metal.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,20 \pm 0,01$ kg/l.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 72%.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Shkalla e hapjes: ≥ 10 m²/litër, në sipërfaqe të lëmuara.
- Viskoziteti: rreth 95 ± 5 KU.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 4 orë, në kushte standarde 23°C / 50% RH.
- Aftësia mbuluese: $\geq 99,5\%$ – Klasa I, sipas EN ISO 6504-3 ose ekuivalent.
- Klasa e rezistencës ndaj larjes: Klasa I, sipas ISO 11998 ose ekuivalent, ose klasë tjetër ekuivalente.
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 100 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC.
- TVOC – emetimi në ambient: ≤ 20 mg/m³, sipas ISO 16000-9 ose ekuivalent.
- Ngjyra e bojës do të caktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës ose përpara furnizimit, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Primer/astar antiruxho për trajtimin e strukturës metalike

- Lloji i rrëshirës: rrëshirë alkide, ose ekuivalent antikorroziv.
- Dendësia: sipas standardit EN ISO 2811-1 ose ekuivalent, rreth $1,45 \pm 0,02$ gr/ml.
- Mbetja e thatë: sipas standardit EN ISO 3251 ose ekuivalent, jo më pak se 75%.
- Shkalla e hollimit: 10–20%, sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Viskoziteti: rreth 115 ± 5 KU, ose ekuivalente sipas skedës teknike të prodhuesit.
- Koha e tharjes: jo më shumë se 2–4 orë, në kushte standarde 23°C / 50% RH,.
- VOC në produktin e gatshëm: ≤ 100 g/l, sipas Direktivës Evropiane 2004/42/EC ose ekuivalent.
- TVOC – emetimi në ambient: ≤ 20 mg/m³, sipas ISO 16000-9 ose ekuivalent.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. Argumentimi për stolin dekorativ me krahë gize

Kërkesa për stol dekorativ me krahë gize është vendosur në funksion të nevojës së autoritetit kontraktor për pajisjen e lulishteve, parqeve, shesheve dhe ambienteve të tjera publike me elementë urbanë funksionalë, estetikë dhe të qëndrueshëm. Stoli do të përdoret nga qytetarët në ambiente të hapura, ndaj është e nevojshme që materiali, përmasat, mënyra e ndërtimit dhe trajtimi i sipërfaqeve të garantojnë përdorim të sigurt, jetëgjatësi dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike.

Përcaktimi i strukturës me këmbë/krahë gize është vendosur për shkak të qëndrueshmërisë mekanike, peshës, jetëgjatësisë dhe përshtatshmërisë së këtij materiali për përdorim në ambiente të jashtme. Përdorimi i ristelave prej druri është vendosur për të garantuar komoditet në përdorim,

përshtatje estetike me ambientin urban/gjelbërues dhe funksionalitet të produktit. Termi “ose ekuivalent” është përdorur për të mos kufizuar konkurrencën dhe për të pranuar materiale/zgjidhje me qëndrueshmëri të barasvlershme.

Përmasat kryesore të stolit janë vendosur për të garantuar përdorim normal nga qytetarët, ergonomi, stabilitet dhe përshtatje me hapësirat publike ku do të vendosen. Toleranca $\pm 3\%$ shmang skualifikime formale për devijime të vogla teknike që nuk ndikojnë në funksionalitetin e produktit.

Kërkesa për 8 ristela druri dhe elementët fiksues rezistentë ndaj korrozionit lidhet me qëndrueshmërinë e produktit dhe përdorimin në ambient të jashtëm. Dimensionet e vidave dhe elementëve të fiksimit janë lënë orientuese dhe me mundësi ekuivalence për të mos përjashtuar sisteme të tjera fiksimi me siguri të njëjtë ose më të lartë. Kërkesat për bojë, astar, llak, bojë metalike dhe primer antiruxho janë vendosur për të garantuar mbrojtjen e drurit dhe metalit nga lagështia, rrezatimi UV, korrozioni dhe konsumimi nga përdorimi publik. Parametrat teknikë janë shoqëruar me “ose ekuivalent”, ndërsa TVOC/VOC janë përcaktuar me kufij maksimalë ose brenda kufijve të lejuar, për të garantuar përshtatshmëri për ambiente publike dhe për të shmangur lidhjen me një produkt/markë të caktuar.

Përveç sa më sipër, produkti i kërkuar është përshtatur me tipologjinë e stolave ekzistues të instaluar në rrugë, lulishte, parqe dhe hapësira të tjera publike të Bashkisë Tiranë, me qëllim ruajtjen e uniformitetit urban, harmonizimin estetik të mobilimit publik, si dhe lehtësimin e mirëmbajtjes dhe administrimit të tyre. Ky përafrim nuk synon kufizimin e konkurrencës apo orientimin drejt një modeli/prodhuesi të caktuar, pasi specifikimet janë hartuar me toleranca dhe me parashikimin “ose ekuivalent”, duke lejuar produkte me karakteristika të barasvlershme teknike, funksionale dhe estetike.

2. Argumentimi për koshin plastik për mbetje urbane 120 L

Kërkesa për kosh plastik për mbetje urbane 120 L është vendosur për nevojat e autoritetit kontraktor në administrimin e mbetjeve urbane në ambiente publike. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve, lëvizjen e lehtë, zbrazen, përdorimin e përditshëm dhe qëndrueshmërinë në kushte të jashtme.

Volumi 120 L është përcaktuar si kapacitet i përshtatshëm për përdorim publik dhe për administrim praktik nga strukturat e pastrimit, duke garantuar balancë midis kapacitetit të mbajtjes dhe lehtësisë së lëvizjes/manipulimit.

Kërkesa që trupi i koshit të jetë prej HDPE, ose materiali tjetër plastik ekuivalent, është vendosur për shkak të rezistencës së këtij materiali ndaj goditjeve, kimikateve, lagështisë, rrezatimit UV dhe ndryshimeve të temperaturës. Përdorimi i termit “ose ekuivalent” lejon materiale të tjera plastike me karakteristika të barasvlershme, duke ruajtur kërkesën funksionale.

Pesha totale, peshëmbajtja dhe masa totale e lejueshme janë vendosur për të garantuar raport të përshtatshëm midis qëndrueshmërisë, kapacitetit të mbajtjes dhe lehtësisë së përdorimit. Kërkesa

është lënë fleksibël për peshën totale, pasi prodhues të ndryshëm mund të ofrojnë produkte me peshë pak të ndryshme, por me të njëjtën qëndrueshmëri dhe konformitet teknik.

Kërkesa që koshi të jetë në përputhje me EN 840-1:2020, EN 840-5:2020 dhe EN 840-6:2020, ose ekuivalent, është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi këto standarde lidhen me koshat/kontenierët e mbetjeve me rrota dhe përfshijnë kërkesa për përmasat, sigurinë, funksionalitetin dhe testimet përkatëse. Për këtë arsye është hequr kërkesa e veçantë për “markim CE”, pasi konformiteti teknik me EN 840 ose ekuivalent është më i qartë dhe më i lidhur me produktin.

Certifikimet ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, ose ekuivalente, janë parashikuar për prodhuesin e produktit, pasi cilësia e koshit plastik lidhet me procesin industrial të prodhimit, kontrollin e cilësisë, përdorimin e materialit HDPE, trajtimin UV dhe qëndrueshmërinë e produktit. Këto certifikime nuk trajtohen si standarde produkti, por si sisteme menaxhimi të prodhuesit, të lidhura me objektin dhe të formuluar me “ose ekuivalent”.

Dimensionet A, B, C, D, E, F dhe G janë vendosur për të përcaktuar qartë modelin funksional dhe përputhshmërinë e produktit me volumin 120 L dhe përdorimin me rrota. Skica shërben vetëm për identifikimin orientues të këtyre dimensioneve dhe nuk synon imponimin e një prodhuesi të caktuar. Toleranca $\pm 2\%$ dhe pranimi i modeleve ekuivalente shmangin kufizimin e konkurrencës.

Përveç sa më sipër, specififikimet teknike të koshit plastik 120 L janë hartuar duke mbajtur në konsideratë edhe tipologjinë dhe karakteristikat e koshave ekzistues të vendosur në rrugë, lulishte, parqe dhe hapësira të tjera publike të Bashkisë Tiranë. Ky përafrim është bërë me qëllim ruajtjen e uniformitetit të sistemit të grumbullimit të mbetjeve urbane, lehtësimin e përdorimit nga qytetarët, standardizimin e procesit të zbrazjes, lëvizjes dhe mirëmbajtjes nga strukturat e pastrimit, si dhe garantimin e ndërveprimit normal me praktikën dhe pajisjet ekzistuese të shërbimit. Përshtatja me koshat ekzistues nuk synon kufizimin e konkurrencës apo orientimin drejt një prodhuesi/modeli të caktuar, pasi specififikimet janë formuluar me toleranca, me referencë të standardi EN 840 ose ekuivalent, si dhe me pranimin e produkteve që përmbushin të njëjtin funksion, kapacitet, qëndrueshmëri dhe konformitet teknik.

3. Argumentimi për koshin dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri

Kërkesa për kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri është vendosur për nevojën e autoritetit kontraktor për grumbullimin e mbetjeve urbane në ambiente publike ku kërkohet jo vetëm funksionalitet, por edhe përshtatje estetike me mjedisin urban, lulishtet, parqet dhe sheshet.

Kërkesa për strukturë bazë metalike dhe kosh të brendshëm metalik është vendosur për të garantuar qëndrueshmëri mekanike, siguri dhe jetëgjatësi në përdorim publik. Struktura metalike duhet të mbajë peshën e koshit të brendshëm dhe të përballojë përdorimin e përditshëm, goditjet e mundshme dhe ekspozimin ndaj kushteve atmosferike.

Kërkesa për llamarinë të zinguar/çelik të galvanizuar ose material ekuivalent rezistent ndaj korrozionit lidhet me përdorimin në ambiente të jashtme. Spesori jo më pak se 2 mm për strukturën

dhe jo më pak se 1–1.2 mm për koshin e brendshëm është vendosur si kërkesë minimale për qëndrueshmëri mekanike dhe rezistencë ndaj deformimeve.

Ristelat e drurit janë vendosur për arsye estetike dhe funksionale, pasi krijojnë veshje dekorative të jashtme dhe e bëjnë produktin të përshtatshëm për vendosje në ambiente urbane/gjelbëruese. Përmasat e ristelave janë vendosur për të garantuar mbulim të mjaftueshëm të strukturës dhe qëndrueshmëri në montim, ndërsa toleranca $\pm 3\%$ dhe parashikimi “ose ekuivalent” shmangin orientimin drejt një modeli të vetëm.

Kërkesa që koshi të ketë derë metalike me çelës është vendosur për të mundësuar vendosjen, heqjen, zbrazjen dhe mirëmbajtjen e koshit të brendshëm nga personeli përgjegjës, duke shmangur ndërhyrjen e paautorizuar. Menteshat e fshehura ose sistemi tjetër ekuivalent lidhen me sigurinë, estetikën dhe mbrojtjen nga dëmtimet.

Kërkesat për llak druri, bojë metalike dhe primer/astar antiruxho janë vendosur për të garantuar rezistencë ndaj lagështisë, korrozionit, rrezatimit UV dhe konsumimit nga përdorimi i jashtëm. Parametrat janë shoqëruar me “ose ekuivalent” dhe TVOC është vendosur me kufi maksimal $\leq$, për të garantuar që kërkesa të jetë mjedisore dhe teknike, jo kufizuese ndaj një produkti të vetëm.

Përveç sa më sipër, specifikimet teknike të koshit dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri janë hartuar duke mbajtur në konsideratë edhe tipologjinë, formën dhe karakteristikat e koshave dekorativë ekzistues të instaluar në rrugë, lulishte, parqe, sheshe dhe hapësira të tjera publike të Bashkisë Tiranë. Ky përafrim është bërë me qëllim ruajtjen e uniformitetit estetik të mobilimit urban, harmonizimin e elementëve dekorativë me ambientin publik ekzistues, lehtësimin e mirëmbajtjes, zëvendësimit dhe administrimit të tyre nga strukturat përgjegjëse, si dhe sigurimin e një pamjeje të unifikuar në hapësirat publike. Përshtatja me koshat ekzistues nuk synon favorizimin e ndonjë prodhuesi, modeli apo operatori ekonomik të caktuar, pasi specifikimet janë formuluar me toleranca, me parashikimin “ose ekuivalent” dhe me pranimin e zgjidhjeve që ruajnë të njëjtin funksion, qëndrueshmëri, siguri dhe karakter estetik/dekorativ.

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia
1	Stol dekorativ me krahë gize	Copë	350
2	Kosh plastik për mbetje urbane 120 L	Copë	30
3	Kosh dekorativ metalik me strukturë rrethuese druri	Copë	49

Afatet e lëvrimit: - 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Vendi i dorëzimit të mallit është pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, rruga “5 Maji”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

- Roven Balliu Person përgjegjës për prokurim, (Specialist i I-rë në DJP)
- Ledio Nuredini Anëtar (Specialist i I-rë në DJP)
- Elvin Kurti Anëtar (Specialist i II-të në DZHMJQ)